


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 639/ Prot.
14



LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- Vendimin Administrativ Nr. 21 datë 08.08.2024 i Degës së Doganës Shkodër ndaj subjektit "Arton Berisha" PF me NIPT M06823001K, me adresë në: Shkoder Rruga Evlia Çelebiu, ndertesa nr.66, ne Qendren Tregtare Zdrale, Telefon: 075443520.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

Aida DIZDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 638/ Prot.
2

Shkodër, më 08.08.2024

V E N D I M
Nr. 21, datë 08.08.2024

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, mori në shqyrtim, shkresën nr. 11604/140 prot., datë 20.02.2024, të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Lënda: Dërgohet raport përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin me objekt "Auditim përputhshmërie" me nr.283/93 prot., datë 19.02.2024 të KLSH-së (protokolluar me tonën me nr. 435 prot., datë 27.02.2024), Konkluzionet e grupit të punës mbi raportin e Auditit të KLSH-së protokolluar me nr.435/5prot., datë 07.08.2024 dhe procesverbal **nr.638 prot., datë 26.03.2024** të mbajtur nga grupi i punës sipas Urdhërit të Brendshëm nr.10, datë 12.03.2024 të Degës së Doganës Shkodër i ngritur për shqyrtimin e materialit të dërguar nga Audituesit e KLSH-së, lidhur me konstatimet e bëra për subjektin "**Arton Berisha**" PF me NIPT M06823001K, me administrator z.Armir Borshi dhe adresë në: Shkoder Rruga Evlia Çelebiu, ndertesa nr.66, ne Qendren Tregtare Zdrate, Telefon: 075443520.



Pasi u shqyrtua dokumentacioni i mësipërm rezulton se:

Subjekti "**Arton Berisha**" PF me NIPT M06823001K, me deklaratën doganore R 1910, datë 03.06.2022 ka importuar dhe deklaruar për zhdoganim, artikullin "*bojë floku*".

Në raportin përfundimtar të auditimit, për subjektin "**Arton Berisha**" PF me NIPT M06823001K, me administrator z.Armir Borshi dhe adresë në: Shkoder Rruga Evlia Çelebiu, ndertesa nr.66, ne Qendren Tregtare Zdrate, Telefon: 075443520 rezulton se:

Në lidhje me vlerësimin doganor të mallrave të deklaruara në Kapitullin *33* të Nomenklaturës së Mallrave në RSH për mallin e deklaruar ne kodin 33 "*Bojë floku*", konstatohet se nuk është marrë në konsideratë për trajtim vlerësimi sipas metodës së nenit 65 deri 70 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, pasi janë evidentuar trajtime dhe procedura të kryera jo sipas kërkesave të Sesionit të Udhëzimit 3, datë 23.01.2018, që lidhen me vlerësimin doganor.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti importues, ai nuk plotëson kushtëzimet ligjore për tu vlerësuar sipas metodës së transaksionit.

Nga sa më sipër, niveli i vlerësimit doganor për këtë artikull duhet të ishte trajtuar ne nivelin 0.8 Euro/kg sipas Dosjes së të Dhënave të Disponueshme në RSH, duke rezultuar me detyrimet si më poshtë;

Dega Doganore	Subjekti	NIPT	Nr. Dav-i	Malli	Detyrim doganor shtesë (lekë)
Shkodër	Arton Berisha PF	M06823001K	1910	Bojë floku	17,293
TOTALI					17,293

Si rrjedhim, grupi i punës pranë Degës së Doganës Shkodër është i të njëjtit mendim me grupin e auditit të KLSH-së në lidhje me rivlerësimin doganor.

Për këtë arsye, është bërë rillogaritja e detyrimeve për deklaratën doganore **R 1910, datë 03.06.2022**, në të cilën subjekti **“Arton Berisha” PF me NIPT M06823001K** duhet të paguajë shumën 17.293 lekë.

Me anë të shkresës nr. 638/1 prot., datë 26.03.2024 Dega Doganore ka bërë njoftimin e procesverbalit të konstatimeve të audituesve të KLSH-së, hartuar nga grupi i punës pranë DDSH, me anë të së cilës subjekti **“Arton Berisha” PF me NIPT M06823001K** nuk ka marrë njoftim. Zarfi postar është kthyer me shënimin **“i panjohur”**. Për procesverbalin e mësipërm është njoftuar edhe agjenti doganor z. Vildan Dani i cili ka marrë njoftim me datë 28.03.2024 (sipas nënshkrimit) dhe nuk ka paraqitur observacion.

Për sa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër, në analizim dhe shqyrtim të dokumentacionit të mësipërm, pikën 3, të nenin 70 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM –në Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit nr. 102.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Pikën 4.5 dhe 4.6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, datë 23.1.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganor” dhe Udhëzimin nr. 05, datë 26.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Mbi Procedurat Standarte të Funksionimit të Sektorit të Vlerësimit Qendror dhe Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ”.

V E N D O S I:

1. Për deklaratën doganore **R 1910, datë 03.06.2022**, të deklaruar nga subjekti **“Arton Berisha” PF me NIPT M06823001K**, të zbatohet vlerësimi doganor bazuar në pikën 3, të nenin 70 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Detyrimi doganor shtesë që duhet paguar është **17,293 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë**.
3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizim.
4. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Specialist aposterior/analizë risku pranë Degës së Doganës Shkodër për pasqyrimin e këtij vendimi në sistemin AW dhe amendimin e deklaratës doganore.
5. Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

KRYETAR

AIDA DIZDARI

